



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.113/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kimete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit të tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.113/2019 e datës 27.09.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 27.09.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 27 Shtator 2019 rreth orës 14:30, në Komunën e Mitrovicës, saktësisht në hyrje të shkollës fillore “Andon Zako Çajupi”, në një distancë jo më larg se 3 metra nga hyrja e shkollës, shihet posterit i kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës Safet Kamberi. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore nr.13/2013, “Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”, përkatësisht neni 3 pika 3.4. Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 28.09.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), thekson se ankesa e paraqitur nga organizata BIRN dhe IKS Anr.113/2019, me date 27.09.2019 është e pabazë, sepse posterit i vendosur nuk është në kundërshtim me rregullën zgjedhore nr.13/2013, neni 3 pika 3.4, ngase për këtë Komuna e Mitrovicës – Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm ka lidh kontratë për dhënie në shfrytëzim dhe menaxhim të sipërfaqeve reklamuese për billborde, city ligh dhe llamposte. Më tutje parashtruesi i përgjigjes thekson se dispozitat ligjore të LZP-së, gjegjësisht neni 33 pika b) nuk e specifikon largësinë apo afërsinë e vendosjes në rastin konkret të posterit, e as dispozitat e Rregullave 11/2013, dhe Rregullës 13/2013 nuk janë aq strikte sa për të përcaktuar shkelje vendosjen e materialeve zgjedhore edhe në afërsi të objekteve. Me tutje subjekti politik LDK, në përgjigje thekson se neni 3.3 i rregullorës 13/2013, në një pjesë të tij thotë se “...vendet e tilla duhet të caktohen në hapsirat më të frekuentuara dhe më të dukshme në atë komunë”, çka e përjashton

pretendimin e palës ankuese se kandidati i LDK-së për deputet ka bërë shkelje me rastin e vendosjes së posterit në fjalë. Po ashtu vendi se ku është vendosur posteri në fjalë është objekt (billboard) që i takon apo e ka në posedim kompania private, për të cilën hapësire ajo paguan qira të shfrytëzimit (posedimit faktik).

Si dëshmi për pretendimet e tyre subjekti politik LDK përgjigjes i ka bashkangjitur kontratën për dhënien në shfrytëzim dhe menaxhim të sipërfaqeve reklamuese për billborde, city ligh dhe llamposte dhe kontratën mbi dhënien me qira të hapsirave tona reklamuese.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimin e paraqitësit të ankesës lidhur me atë se posteri i kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës është vendosur në hyrje të shkollës fillore “Andon Zako Çajupi”, në një distancë jo më larg se 3 metra nga hyrja e shkollës, në këtë periudhë kohore është i pabazuar, dhe nuk përbënë shkelje te nenit 3 pika 3.4 të Rregullës Zgjedhore nr.13/2013, “Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”, ngase këto veprime janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së zgjedhjeve, nëse objekti në të cilën pretendohet se është i vendosur posteri 3 metra larg shërben si Qendër e Votimit, sipas nenit 85 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet, se: *“Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose Menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji”*

Periudha kohore për të cilën parashihet të aplikohet dispozita e lart cituar ligjore është 24 orë para procesit të votimit dhe gjatë ditës së votimit, nëse objekti në të cilën pretendohet se është vendosur posteri afër tij shfrytëzohet si qendër e votimit ne ditën e votimit, andaj paneli erdhi në përfundim se pretendimet e paraqitësit të ankesës, janë të paqëndrueshme dhe bazuar në arsyet e theksuar më lartë, dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.113/2019 më datën 30.09.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 148 par. 4 të LZP-së.